



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:029459  
Datë: 19.04.2024  
Numri i dokumentit: 05644090

KF.nr.673/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “L&L” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811016999, me seli në Prishtinë, rr. “Hilmi Rakovica”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fatos Zeqiri avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 04.04.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse avokat Fatos Zeqiri, dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “L&L” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811016999, me seli në Prishtinë.
- II. MBETET në fuqi Vendimi nr.392/2020 i datës 30.12.2020 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 16.02.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.392/2020 i datës 30.12.2020. Si në padi ashtu edhe në seancat gjyqësore deklaroi se vendimi i nxjerr nga e paditura është i kundërligjshëm për shkak se i njëjti është në kundërshtim me

dispozitat materiale të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Ligjin 05/L-029 për TAK, UA 02/2016, UA 15/2010. Më tej ka theksuar se paditësi ka pasur avanse të pranuar nga dy kompani jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe atë nga kompania “Uliks DOO nga Mali i Zi dhe “Cronimet” gmbh nga Gjermania. Me kompaninë Uliks doo paditësi gjatë përpilimit të raportit ka ofruar dëshmitë e avanseve si Kontratën e avansit dt.26.12.2018, profaturat për të gjitha parapagimet që janë bërë në emër të profaturave, korrespondencat me e-mail nga banka për gabimet teknike në përshkrim të transaksionit në vendi të pro-invoice përshkrimi është bërë si invoice transaksionet për avans janë bërë me vlera fikse. Paditësi gjatë paraqitjes së vërejtjeve në draft raport ka kundërshtuar trajtimin e avansit si të hyrë përmes provave të lartcekura, dhe gjithashtu ka dhënë sqarimin e tij se kur trajtohet një avans si e hyrë dhe cilat kushte duhet ti paraprijnë dhe atë si vijon: të ketë nënvlerësuar çmimin e shitjes, të ketë të dhëna doganore se malli e ka kaluar kufirin, DUD-i, të ketë mbivlerësuar stoqet, të ketë konfirmim nga dhënësi i avansit se vlera e tillë është blerje për të. Tutje shton se në lidhje me sqarimin e avansit nga kompania “Cronimet” gmbh, paditësi ka ofruar dëshmitë e avansave si konfirmimi nga kompania “Cronimet” gmbh dt.28.09.2020. në korrespondencat me e-mail me kompaninë në fjalë nuk ekzistojnë transaksione që shkruan pagesë për invoice sikur që është cekur në raport kontrolli. Kontrata dhe konfirmimi të ofruara në cilësinë e provave materiale nga kompanitë e cekura, nuk janë marrë fare parasysh nga inspektori me rastin e përpilimit të Raportit duke mos u lëshuar fare në shqyrtimin e këtyre provave. Në lidhje me ndryshimin e KMSH-së për vitin 2015 paditësi ka kërkuar sqarim lidhur me rritjen e stoqeve dhe zbritjen e KMSH-së por paditësit nuk iu është ofruar. Rritja e shitjeve dhe rritja e stoqeve në të njëjtën kohë nuk përkon me natyrën e punës, e kundërta mund të ndodhë që kur ka qarkullim shtesë mund të zvogëlohen stoqet, por jo edhe kundërta ashtu siq pretendon inspektori tatimor. Rritja e stoqeve ka ardhur si rezultat i mos kalkulimit të saktë të KMSH-së, me datë 28.08.2015 paditësi ka pasur shitje 24,94 Ton në vlerë prej 9304€ dhe kjo vlerë nuk iu ka njohur si dalje. Shpenzimet e derivateve po ashtu nuk janë cekur si ndonjë dëshmi relevante për arsyen e mos njohjes së këtyre shpenzimeve, por është cekur në raportin e kontrollit se këto shpenzime nuk njihen si të zbritshme si për çështje të TVSH ashtu edhe për çështje të tatimit në Fitim. Inspektori Tatimor ka bërë shkelje edhe të dispozitave të nenit 15.3.2 të Ligjit 05/L-029 për TAK. I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.04.2024 ka theksuar se vazhdojnë të qëndrojnë pranë padisë dhe kërkesëpadisë për shkak se konsiderojnë që vendimi i të paditurës është i kundërligjshëm dhe i njëjti duhet të anulohet pjesërisht ashtu që paditësi të lirohet nga tatimi në vlerën prej 45,146.79 euro për

periudhën tatimore 2015 dhe vlerën prej 45,313.31 për periudhën tatimore 2016 duke përfshirë edhe ndëshkimet në vlerë ë prej 22,614.00 euro që ka rrjedhë nga kjo periudhë tatimore.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 21.03.2021 e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe vlerëson se vendimi i kundërshtuar ka mbështetje ligjore. Tutje ka shtuar se paditësi asnjëherë dhe me asnjë dëshmi nuk ka arrit të provoj se mjetet e pranuar nga dy kompanitë kanë qenë avanse. Pretendimi i paditësit se provat e ofruara dëshmojnë se mjetet janë pranuar në formë të avanseve janë të paqëndrueshme sepse kjo provë është trajtuar dhe kjo shihet nga Raporti i rikontrollit. Kjo dëshmi konfirmim nga kompania Cronimet është trajtuar, mirëpo përmbajtja e këtij konfirmimi nuk parqet dëshmi për tu marrë për bazë dhe që pastaj mbi bazën e këtij konfirmimi ato mjete të mund të konsiderohen si avanse. Me dt.13.07.2019 paditësi ka dërguar përmes i-meilit saldon e cila është më vlerë prej 1,475,476.45€ përderisa dokumenti-konfirmimi nga Cronimet për periudhën 2014-2015 konfirmon pagesat për paditësin në vlerën 1,363,581.58€, pra edhe sikur të ishte e vetmja dëshmi që kërkohet për të vërtetuar se këto mjete kanë qenë avanse prapëseprapë ka mospërputhje. Nga raporti i kontrollit janë të listuara të gjitha dëshmitë që i janë kërkuar paditësit për mjetet e pranuar avans. Sa i përket arsytimit se dëshmitë nga institucionet tatimore të vendeve tjera (mali i Zi, Gjermani) nuk ka mund të kërkohen, ATK-ja ka tentuar vet të marr informata nga Gjermania mirëpo i është refuzuar kjo kërkesë me arsyetimin se nuk mund të jepen këto informata sepse nuk mbulohen nga METD-ja meqë ajo është marrëveshje nga periudha e ish Jugosllavisë, ndërsa me malin e Zi, dhe Republikën e Kosovës nuk ka METD. Të rëndësisë së veçantë kanë qenë edhe dëshmitë bankare që vërtetojnë se përshkrimet për këto transaksione kanë qenë të gabuara pra se në vend të përshkrimit pro-faturë, është bërë përshkrimi faturë, mirëpo as këto dëshmi paditësi nuk ka arrit ti ofroj. Sa i përket konfirmimeve bankare lidhur me transaksionet nga kompania Cronimet nuk janë ofruar fare këto dëshmi sa i përket të hyrave nga Uliks Doo, këto dëshmi nga banka janë ofruar vetëm për mjetet që janë pranuar në periudhë jashtë objektit të kontrollit, paditësi përmend edhe një kontratë të avanseve me Uliks Doo, mirëpo kjo kontratë është e datës 26.12.2018 pra periudhë jashtë kontrollit. Sa i përket rritjes së stokeve dhe ndryshimit të KMSH-së për vitin 2015, rikontrolli ka bërë verifikimin e stokut përkatësisht analizën materiale të mallrave tek paditësi, ky verifikim është bazuar në libra dhe regjistrime si dhe në deklaratimet e tatimit pra janë verifikuar materialisht hyrje daljet mbetja për të gjithë artikujt. Paditësi posedon 3 artikuj, një që e blen nga Newco Feronikeli i cili është një lloj i xehes që quhet converter slag, i cili

përpunohet dhe nga ky produkt dalin dy produkte tjera: mbetje metalurgjike dhe Fen. Këto dy produkte janë për shitje ndërsa converter slag nuk përdoret për shitje. Pra në këtë analizë shihet sasia e blerë nga Feronikeli e artikullit converter slag, sasia e hyrë në proces të prodhimit si dhe sasia e dalë e materialit Fen me përmbajtje të hekurit. Pas analizimit janë konstatuar ndryshime në stoqet e paditësit për vitin 2015. Paditësi në deklaratën vjetore CD/2015 ka paraqit stoqe në fund në vlerën 959,412.00€ kurse sipas kartelave materiale të artikujve janë 1,009,884.72€, pra kemi një diferencë prej 50,472.72€. Me ri kontroll janë marrë për bazë stoqet sipas kartelave materiale duke pasur parasysh kronologjinë. Duke qenë se paditësi blen vetëm converter slag, dhe se çmimi i blerjes për këtë material është 20.00€ për Ton, bazuar në këtë analizë është bërë përlllogaritja e kostos si dhe është nxjerr diferenca e lartcekur. Dy pikat e kontestit me mos pranimin e shpenzimeve dhe shpenzimet e zhvlerësimit nuk kanë qenë objekt i procedurës së rikontrollit, çështja e shpenzimeve nuk është trajtuar as nga Raporti i DKK-së. Këto pika kanë mbetur ashtu siç janë konstatuar me kontrollin e parë dhe se ndaj këtij vlerësimi paditësi nuk kishte parashtruar ankesë për ta kontestuar vlerësimin. Andaj bazuar nga të thënat e lartpërmendura, i propozojnë gjykatës që pas administrimit të provave ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke lënë në fuqi vendimin nr.392/20 dt.30.12.2020 të D.A. pranë ATK-së.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.04.2024 për të paditurën nuk ka prezantuar askush, por me parashtresën e datës 03.04.2024 e njëjta e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar që gjykata të veprojnë sipas nenit 38 paragrafi 5 i Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ. Me të njëjtin njoftim ka theksuar se mbetet pranë përgjigjes në padi me kërkesë që të refuzohet padia/ankesa e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.392/2020 i datës 30.12.2020.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke vepruar sipas ankesës së të paditurës, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 1153/22, të njëjtën e ka aprovuar ashtu që ka prish Aktgjykimin e Divizionit Fiskal të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.334/21, dhe të njëjtën i ka kthyer dhomave të shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje. Me vërejtje se në ri-procedurë gjykata duhet t'i vlerësojë provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në veçanti të shqyrtohet nëse mjetet të cilat i ka pranuar paditësi si avanse dhe kompanitë nga të cilat i ka pranuar këto mjete janë persona të ndërlidhur sipas Nenit 1 par.1.27 të Ligjit për Administratën

Tatimore dhe Procedurat. Në këtë drejtim, gjykata ka për detyrë të vlerësojë se mjetet e pranuar si avanse nga paditësi a i janë nënshtruar trajtimit të duhur tatimor si avanse, para se kjo të vlerësohet nga ana e ekspertit. Po ashtu, është me rëndësi të sqarohet fakti se paditësi a i është përmbajtur detyrimit ligjor për deklarimin e avanseve në TVSH, e në veçanti të vështrohet se a përputhen dëshmitë bankare me periudhën e raportit të kontrollit. Të gjitha këto fakte janë të rëndësishme për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, të cilat gjykata e shkallës së parë ka për detyrë që t'i sqarojë në procedurën e provave. Varësisht nga vlerësimi, gjykata mund të kërkojë sqarime shtesë nga eksperti financiar lidhur me pretendimet e tilla nga e paditura. Pas vlerësimit të provave, gjykata duhet t'i analizojë dhe zbatojë drejtë dispozitat ligjore, e më pas – pasi të ketë vlerësuar bazën ligjore të vendos për vendimin kontestues në këtë procedurë të konfliktit administrativ.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 04.04.2024, ka administruar provat si në vijim: përgjigja në padi e dt.14.10.2021 nga ATK-ja, vendimi nr.392/2020 i dt.30.12.2020 nga ATK-ja, Raporti i Kontrollit i dt.09.10.2020, ankesa e paditësit nr.prot.392/2020 e dt.02.11.2020, Procesi i seancës së dt.09.12.2020 nga ATK-ja, Marrëveshja e avansit ndërmjet “L&L” sh.p.k. dhe kompanisë Uliks DOO, profaturat me Uliks Doo, Konfirmimi nga NLB Bank-Mali i Zi për gabimin teknik në përshkrim të faturave, komunikimet me e-mail, bilanci i gjendjes dhe shpalosja, konfirmimi i parapagimit dhe Cronimet GmbH, komunikimi me e-mail, dhe Bankat ku është vëre pagesa, pasqyra e të ardhurave me kartelat individuale për secilin shpenzim, Formulari i deklarimit vjetor tatimit në të ardhura të korporatave 2015, 2016 dhe 2017, Kartela me Uliks 2015-2020, Kartela me Cronimet GmbH 2014-2015, dhe shpenzimet e transportit, shpenzimet bankare 2015, 2016, Tabela e aseteve dhe zhvlerësimi i tyre, Kontratat, DUD-at e blerjes se aseteve, Kopjet e faturave të pa pranuar të derivateve dhe kartela, Licenca e punës e lëshuar nga MMPH, ekspertiza financiare e dt.31.01.2022 dhe shtojca e Ekspertizës.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, vërejtjeve të dhëna nga Dhomat e Shkallës së dytë, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në arsyetimin e vendimit kontestues me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit, e paditura theksohen se pagesat avance nuk janë të mbështetura në prova materiale, nuk është bërë ndërlidhja e faturimeve me faturat e rregullta kur ka ndodh furnizimi i mallit, dhe se këto transaksione për qëllime tatimore janë të trajtuar si të pa deklaruar. Në lidhje me ndryshimin e sasisë së stokut në periudhën tatimore 2015, nga analiza materiale e stokeve, blerjeve shitjeve dhe stokut në fund është konstatuar se ka ndryshim të sasisë së stokut në periudhën tatimore 31.12.2015. Sa i përket kontesteve tjera lidhur me mos pranimin e shpenzimeve të derivateve, bankare dhe të zhvlerësimit, e paditura vendos që të njëjtat të mbeten në fuqi sipas vlerësimit të kontrollit paraprak, për të cilën paditësi nuk ka dorëzuar ankesë në Divizionin e Ankesave, andaj si të tilla nuk kanë qenë objekt i rikontrollit.

Gjykata nga Raporti i Kontrollit i datës 06.10.2020, ka konstatuar se si rezultat e këtij kontrolli ka rezultuar me ngritjen e qarkullimit në TVSH, ngritjen e të ardhurave në TAK, në uljen e shpenzimeve operative dhe paraqitjen e tatimit shtesë në TAK dhe në TVSH. Gjykata ka shqyrtuar llogarit bankare, konfirmimet e pagesave të dy subjekteve Uliks Mali i Zi dhe Cronimet GmbH-Gjermani, për vitin 2015-2016, nga të cilat prova materiale e paditura ka bërë tatimin e avancave bankare duke e ngarkuar paditësin me tatim shtesë sipas rekomandimeve të Departamentit të kualitet të kontrollit-ATK-së.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi, dhe në seancë sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 01.11.2021 ka dhënë sqarimet se nuk ka mund të siguroj informatat nga Gjermania dhe Mali i Zi për shkak të mungesës së marrëveshjeve reciproke. Për të vërtetuar drejt vlerësimet e nxjerra nga kontrolli tatimor, që kanë ndikuar në të hyrat shtesë të

paditësit për periudhën 2015, 2016, gjykata në seancën gjyqësore e datës 16.12.2021 duke vepruar sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, ka vendosur që vlerësimi i provave të shqyrtuara në procedurën administrative të bëhet përmes ekspertizës financiare gjyqësore.

Nga ekspertiza financiare e datës 19.01.2022 e punuar nga eksperti financiar gjyqësor, Mentor Prekazi, është dhënë mendimi se avanset e pranuar në xhirollogarinë bankare BPB 2015, 2016 të paditësit, pas krahasimit të raporteve të deklaruara më librat e shitjeve në raport me listën e eksporteve të Doganës së Kosovës për vitet 2015, 2016 dhe analizës së bilancit të gjendjes 2015-2016, në tërësi përputhen deklaratimet e paditësit me librin e shitjeve dhe listën doganore të eksporteve. Ndërsa stoqet dhe KMSH-në paditësi nuk ka dëshmuar ndryshimet e vlerësimit të kontrollit tatimor. Më tej në ekspertizën financiare dhe në seancën e shqyrtimit kryesor eksperti financiar ka sqaruar se ka kërkuar listën e eksporteve në Doganën e Kosovës për paditësin dhe me datën 19.01.2022 ka pranuar listën e eksporteve. Nga kjo listë eksporteve të krahasuar me librin e shitjeve eksperti financiar vlerëson se deklaratimet e paditësit, në librin e shitjeve bazuar në faturat e rregullta përputhen në tërësi me listën doganore të eksporteve. Në bilancin e gjendjes së paditësit për vitin 2015 janë pasqyruar avanset me përshkrim obligimi ndaj avanseve të pranuar në vlerën prej 986,359.00€ (2014), 1,428,814.00€ (2015) dhe 1,881,947.00€ për vitin 2016. Nga kjo rezulton se rritja e avanseve për vitin 2015 ka qenë 442,455,00€ ndërsa për vitin 2016 prej 453,133.00€, Këto vlera eksperti financiar i konfirmon se janë pasqyruar nga paditësi në bilancin e gjendjes për vitet 2015 dhe 2016. Paditësi nuk ka bërë deklarin e avanseve të pranuar në deklaratat mujore të TVSH-së. Në seancën gjyqësore të datës 04.04.2024, gjykata përsëri ka dëgjuar ekspertin financiare Mentor Prekazi i cili ka deklaruar se: *Me qëllim që të identifikoj gjendjen reale eksperti financiare ka bërë analizën e dokumentacioneve respektivisht krahasimet e librave të shitjes në krahasim me deklaratat e tvsh dhe me listën e eksporteve të Doganës së Kosovës. Të gjitha evidencat janë të barazuara për vitet 2015-2016 në përjashtim të avanseve. Avanset janë trajtuar si e hyrë e shtyrë nga paditësi të cilat të hyra të shtyrë ai ka zbatuar dhe deklaruar gjatë viteve të mëvonshëm 2017, 2018 e tutje, gjë që ka shkaktuar dyfishimin e obligimit tatimor. Po ashtu ka sqaruar se vet fakti që DKK ka dhënë vërejtje për shkak të mos analizës të pasqyrave financiare vërteton se është bërë dyfishimi i obligimeve tatimore. Pavarësisht kësaj eksperti financiar ka kërkuar nga paditësi pasqyrat financiare për vitet 2018-2019, dhe ka vërejtur se në këto vite ka pasur zvogëlim të avanseve të pranuar, respektivisht zvogëlim të fitimit të shtyrë, gjë që mund të shihet në bilancin e*

*gjendjes për vitet e apostrofuara. Lidhur me përputhshmërinë e librave ka sqaruar se, eksperti financiar e ka konstatuar barazimin e plotë të evidencave financiare për vitet 2015-2016, ndërsa lidhur me eksporte ka deklaruar se Bazuar në ligjin e Tvsh-së 05/L-037 i cili është i plotfuqishëm ende, të gjitha eksportet të mallit jashtë vendit janë të liruara nga obligimet e tvsh-së. Prandaj të gjitha avanset e pranuar të cilat janë të identifikuara që kanë të bëjnë me subjektet afariste jashtë vendit në brendinë e vet nuk e kanë Tvsh-në. Bazuar në këtë eksperti financiar ka dhënë mendimin se nuk kemi të bëjmë me implikim të tvsh-së. Tutje ka sqaruar se: Bazuar në ligjin e tvsh-së 05L-037 i cili është i plotfuqishëm ende, të gjitha eksportet të mallit jashtë vendit janë të liruara nga obligimet e tvsh-së. Prandaj të gjitha avanset e pranuar të cilat janë të identifikuara që kanë të bëjnë me subjektet afariste jashtë vendit në brendinë e vet nuk e kanë tvsh-në. Bazuar në këtë eksperti financiar ka dhënë mendimin se nuk kemi të bëjmë me implikim të tvsh-së.*

Gjykata nga të gjitha provat e administruara konstaton se e paditura gjatë kontrollit kur ka analizuar të gjitha dokumentacionet dhe transaksionet bankare në periudhën tatimore 2015-2016, ka vepruar drejtë kur paditësin e ka ngarkuar me qarkullimin shtesë dhe ndëshkimet si në raport.

Nuk është kontestuese nëse eksportet dhe avanset ishin të përfshira në librin e shitjes së këtu paditësit, kontestuese ishte nëse paditësi i ka deklaruar avanset e pranuar ashtu siç obligohet me dispozitat ligjore.

Neni 29 i Udhëzimit Administrativ nr. 03/2015 për Zbatimin e Ligjit për Tatimin në Vlerën e Shtuar, përcakton momentin e lindjes së detyrimit dhe ngarkimi me TVSH për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, ashtu që në paragrafin 1.3 përcakton se “1.3.pranimi i pagesës në avanc/paradhënje, para se të ketë ndodh furnizimi i mallit apo shërbimit”.

Prandaj, gjykata konstaton se paditësi ka qenë i detyruar të zbatojë dispozitën ligjore të lartcekur. Se TVSH nuk paguhet për eksporte edhe kjo gjykatë e përkrah pretendimin e paditësit dhe të ekspertit, por që avanset duhet deklaruar e pastaj në rast se të njëjtat janë pranuar lidhur me eksporte, tatimpaguesi ka të drejtë të kërkoj lirim nga TVSH-ja, e njohur si TVSH e zbritshme.



Gjykata nga kontrata për avans e datës 26.12.2018 e lidhur në mes të Uliks Doo dhe paditësi, konstaton se për Uliks Doo si nënshkrues i të njëjtës paraqitet personi me emrin L.L. si drejtor i kompanisë, cili rezulton të jetë person i njëjtë me pronarin e këtu paditësit. Gjithashtu, edhe nga email i datës 17.07.2019, konstatohet e njëjta gjendje. Gjykata po ashtu ka gjetur se nga faqja zyrtare e regjistrimit të shoqërive tregtare të Republikës së Malit të Zi, Uliks Doo si themelues dhe person në shoqëri paraqitet i njëjti person. Ndërsa, për kompaninë Cronimet GmbH, gjykata nuk mund të vërtetoj pretendimin e të paditurës se përfaqësuesit e të njëjtës mund të jenë persona të lidhur me paditësin.

Lidhur me vërejtjen e shkallës së dytë, se mjetet e pranuar si avanse nga paditësi a i janë nënshtruar trajtimit të duhur tatimor si avanse, para se kjo të vlerësohet nga ana e ekspertit. Gjykata sqaron, se eksperti në ekspertizë ka konstatuar se i padituri nuk ka përmbushur kërkesën ligjore të paraqitjes së avanseve të pranuar në deklaratat tatimore – TVSH për vitet 2015 dhe 2016 e cila po ashtu konstatohet nga gjykata me shikim nga deklarata për CD dhe TVSH, të ofruara si prova mbështetëse, rezulton se vlera e pretenduar nga paditësi si avanse nuk është e përfshirë në deklaratat e vitit 2015 dhe 2016. Ndërsa lidhur me dëshmitë bankare, gjykata konstaton se të njëjtat përputhen me periudhën e raportit të kontrollit.

Në aktgjykimin A.nr.334/2021, gjykata kishte refuzuar kërkesëpadinë lidhur me ndryshimet e sasisë së stokut në periudhën tatimore 2015, të cilin vlerësim kontrolli tatimor e ka ndryshuar në bazë të analizës materiale të sasisë së stokut në periudhën tatimore 31.12.2015 dhe analizës materiale të blerjeve dhe shitjeve. Kjo gjendje faktike e vlerësimit të kontrollit është konfirmuar edhe në Mendimin profesional të ekspertizës financiare dt.19.01.2022, se paditësi nuk ka mund të dëshmoj diferencën në stoqe prej 2,523.54 Ton, nuk ka arrit të arsyetoj dallimin në mes të shitjes se Fenit në vitin 2015 respektivisht dallimin e vlerës së KMSH-së prej 128,180.32€ për vitin 2015 në krahasim me vitet 2016 dhe 2017. Përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse në seancën e shqyrtimit kryesor kishte pranuar se nuk ka mund të provoj pretendimet lidhur me stoqet dhe KMSH-në, ndërsa në rishqyrtim i autorizuari i paditësit kishte kërkuar anulimin e pjesërishëm të vendimit kontestues, andaj gjykata në rigjykim nuk trajtoi këtë pjesë të kërkesëpadisë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Vendimi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par.1 dhe nenit 46 par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.673/23, datë 19.04.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.